ORGANI SHQYRTUES i PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI I PEJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**70030-23-8606-1-1-1**
Nr. i brendshëm	**70030-023-018-111**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.SH. "BERVENIKU"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Prishtinë
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10 000
(Kodi postar)

045 615 618
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Avni Murtezi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ntsh.berveniku@hotmail.com
(Adresa elektronike)

26.03.2024
(Data e parashtrimit të ankesës)

N.T.SH. "Berveniku"

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontrate per aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet", datë 14.08.2023 Hapja e ofertave: datë 05.09.2023, në ora 14:00. Kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. Njoftimi mbi vendimin e AK-së datë 09.03.2024 Kërkesa për rishqyrtim datë 13.03.2024 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim datë 07.03.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit në SPITALIN E PEJëS gjatë vlerësimit dhe rivlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet" nuk e ka respektuar Ligjin për Prokurimi Publik, Rregulloren për Prokurim Publik dhe Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik në nenet në vijim : **- Neni 1 Qëllimi;** **- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP-së;** **- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;** **- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;** **- Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë;** **- Neni 10 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kronologjia e aktivitetit të prokurimit "Furnizim me pelet" ZPP dhe komisioni i vlerësimit në Spitalin e Pejës gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk kanë vepruar sipas dispozitave të LPP dhe kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Për më tepër qasja e tyre ka rezultuar me diskriminim të OE N.T.SH. “Berveniku” i cili i ka plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Ne jemi në dijëni se OE N.T.P. “Gresa – Commerce”& MBB Construction SH.P.K nuk i ka ofruar këto dy kritere sic janë kërkuar në dosjen e tenderit, për më tepër për kriteret: Kerkesa 2. Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN – ISO 9001 2015 VEREJTJE CERTIFIKATAT E NATYRES SË NJEJTË (–ISO 9001) ME TE AVANCUARA PRANOHEN (Dëshmia 2. Kopje e certifikatës EN –ISO 9001 2015 valide) dhe Kerkesa 3. O.E OFERTUES DUHET TË DORËZOJË ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST, KJO ANALIZË DUHET TË JETË NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR. DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2 – (Dëshmia 3. ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR- DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2ORIGJINAL OSE KOPJE E NOTERIZUAR), nuk janë konform nenit 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë të LPP dhe nuk janë të noterizuara. Kjo cështje i mbetet për shqyrtim OSHP-së.

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar gjithsejtë 7 operatorë ekonomik. Nga procesi i vlerësimit ishte rekomanduar për kontratë N.T.P. “Gresa – Commerce”& MBB Construction SH.P.K me çmim prej 221,4000.00 € me cmim me të lartë nga të gjithë OE që kanë ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe me një diferencë me të lartë në cmimi prej 45,120 euro nga N.T.SH. “BERVENIKU” si OE i përgjegjshëm.

Arsyeja e eliminimit për OE N.T.SH. “BERVENIKU” është shumë joprofesionale dhe e kundërligjme. N.T.SH. “BERVENIKU” është eliminuar pa arsye sepse dokumentet që kanë supozuar ZPP dhe Komisioni i Vlerësimit se nuk i ka OE N.T.SH. “BERVENIKU”, nuk janë kërkuar fare gjatë procesit të vlerësimit dhe rivlerësimit të ofertave.

Pra, oferta e OE N.T.Sh. “BERVENIKU” nuk është vlerësuar nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave sic kërkohet me LPP, RRPP dhe udhëzuesin për prokurim publik. Për me tepër në Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar drejtuar N.T.SH. “Berveniku” thuhet “Nuk ka sjellë Certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN - ISO 9001 2015, poashtu nuk ka sjellë ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST, dhe nuk ka sjellë CERTIFIKATËN TEKNIKE N+A2, e poashtu nuk kanë sjellë dëshmi se kanë qarkullim financiar ne vlere te përgjithshme për 3 vitet e shkuara ose ne periudhën e shkuar trevjeçarë(20,21,22), e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprinë datën e publikimit te njoftimit për kontrate minimum 360,000 euro, prandaj eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit”, **mirëpo për këto AK Spitali i Pejës nuk ka kërkuar fare sqarime nga OE N.T.SH. “Berveniku”, sqarime këto që sipas nenit 10 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik duhet të kërkohen nga OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit**.

Pra, veprimi ZPP dhe Komisionit të Vlerësimit që sqarimet e nevojshme për procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderve, të mos kërkohen nga OE N.T.SH. “Berveniku” janë edhe shkelje e **nenit 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**, i cili thot “Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP dhe tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim”.

Mos kërkimi i sqarimeve të ofertës së OE N.T.SH. "Berveniku", përvec që është shkelje e LPP dhe legjislacionit sekondar, dëmton AK, OE dhe shpërfaq tendencën se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit nuk e ka pasur për qëllim shfrytezimin efikas, efektiv dhe ekonomik të parasë publike dhe trajtimin e barabartë të OE gjatë procesit të rivlerësimit, sepse për kontratë është rekomanduar OE N.T.P. "Gresa – Commerce"& MBB Construction SH.P.K me çmim prej 221,4000.00 € me cmim me të lartë nga të gjithë OE.

Po ashtu, neglizhenca e ZPP dhe e Komisionit për vlerësimin e ofertave duke mos i vlerësuar drejtë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe duke e stërzgjatur marrjen e vendimit për dhënjën e kontratës për më shumë 6 muaj, ka rezultuar me shkeljen tjetër të LPP, nënshkrimin e **dy kontratave të negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë** për këtë lëndë të kontratës dhe ato me vlerë njëra 45,000 dhe tjetra nuk është publikuar, prandaj nuk e dim vlerën.

Dhe kështu, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe komisioni i vlerësimit duke shkelur mbi parimet e prokurimit publik e kanë dëmtuar buxhetin e AK me qindra mijra euro.

Përvec së më sipër, gjatë vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet" janë bërë edhe shkeljet në vijim:

- Është shkelur neni 1 Qëllimi i LPP-së i cili përcakton qartë që "Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente". Gjithashtu qëllimi i nenit 1 të LPP-së është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
- Është shkelur **neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**, i LPP-së – sepse komisioni i vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk i kanë trajtuar njëtrajtshëm OE pjesmarrës në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet" Pra OE N.T.SH. "BERVENIKU" është diskriminuar duke mos e shpallur fitues edhe pse i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.
- Është shkelur **neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti** – në bazë të të cilit AK duhet të dëshmojë se procesi i prokurimit siguron vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues, ndërsa kontrata i është dhënë OE që është me cmim më të lartë nga të gjithë operatoret ekonomik pjesëmarrës, ndërsa krahasuar me OE N.T.SH. "BERVENIKU" është më i shtrenjtë 45,120 euro.
- Është shkelur **neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve** sepse ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara në dosje dhe dëshmive të ofruara nga OE N.T.SH. "BERVENIKU" por është eliminuar pa arsye dhe kështu është kufizuar konkurrenca dhe është favorizuar OE i preferuar.
- Është shkelur **neni 60 kriteret për dhënien e kontratës** sepse edhe pse në dosjen e tenderit është përcaktuar kriter për dhënien e kontratës tenderi i përgjegjshëm me cmim më të ulët, ndërsa kontrata i është dhënë OE N.T.P. "Gresa – Commerce"& MBB Construction SH.P.K i cili ka cmimin më të lartë. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", kurse N.T.P. "Gresa – Commerce"& MBB Construction SH.P.K i rekomanduar për kontratë është me cmim më të lartë nga të gjithë ofertuesit.
- Është shkelur **neni 10 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, i cili lejon që të**

kërkohen sqarime për dy pretendimet e pa baza se OE N.T.SH. "BERVENIKU" nuk i ka ofruar ato dokumente.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga ZPP që të trajtojë pretendimet ankimore bazuar në LPP dhe legjislacionin sekondar dhe që të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim OE N.T.SH. "BERVENIKU"
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM dhe rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Përvec shkeljeve të paraqitura më lartë nga AK Spitali i Pejës është vërejtur edhe një neglizhencë e qëllimshme në stërzgjatjen e këtij aktiviteti të prokurimit, për të vazhduar me procedurë të negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë më OE të preferuar nga ZPP. Në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet" përvec që procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë nuk do të duhej të zbatohej bazuar në kufizimet ligjore për përdorimin e saj, përdorimi i saj e dëmton buxhetin e AK duke i shpenzuar paratë publike pa kritere dhe me cmime me te larta, si dhe OE .

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik N.T.SH. "BERVENIKU" sh.p.k është taksapagues i rregullt i taksave dhe tatimeve të vendosura me ligjet dhe aktet tjera nën ligjore të Republikës së Kosovës, që janë pjesë e të hyrave shtetrore dhe se një diskriminim dhe trajtim jo i bartabart nga ana e autoriteteve e dëmton dhe pamundëson materialisht zhvillimin dhe funksionimin e veprimtarisë së tyre.

Eleminimi nga konkurrenca pa arsye dhe duke mos i zbatuar kërkesat e LPP dhe legjislacionit sekondar, i sjell OE N.T.SH. "BERVENIKU" dëmet materiale si në vijim:

- Kosto e përgaditjes së ofertës - OE ka investuar në kohe, para, dhe burime profesionale financiare, teknike, operative, etj në përgaditjen e ofertës;
- Humbja e mundësisë për të fituar kontratën, OE kishte planifikuar të fitonte kontraten, dhe nuk arrinë të shpërblehet, OE e humb mundësin tejet të rëndësishme për të siguruar/fitur një kontrat të re;
- Dyshime mbi zbatimin e parimeve të prokurimit publik dhe kornizes ligjore në fuqi;
- Pengesa për tenderime tjera, mos shperblimi me kontratë mund te shkaktoj pengesa perkohesisht ose te perhershem nga të tjera tenderime të organizatave të ngjajshme. Etj

Keto janë vetem disa nga dëmet potenciale që i shkaktohen OE N.T.SH. "BERVENIKU" nga mos shpërblimi me kontratë duke qenë i përgjegjshme dhe me cmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për dhënien e kontratës. Është obligim ligjor i AK Spitali i Pejës që gjatë përdorimit të parasë publike përmes procedurave të tenderimit, të veproj në përputhje të plotë më LPP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*